

POROSITES:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit



PROJEKTI:

Sherbime projektimi dhe mbikqyrje punimesh per projekte te financuara nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve per vitin 2015

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI:

RIKUALIFIKIMI I HAPSIRAVE PUBLIKE DHE RRUGES HYRESE PRANE MEMORIALIT TE RILINDASVE NE GJIROKASTER

PERFITUES:

BASHKIA GJIROKASTER

PROJEKTUES:

J.V. ARKIMADE & TAULANT & VLER-INVEST sh.p.k



"VLER-INVEST"





HYRJE

Baza e punes

Ky specifikim teknik eshte dokument kontraktor eshte hartuar nga studio projektuese enkas per "Rikualifikimin e hapsirave publike dhe rruges hyrese prane "Memorialit te Rilindasve" ne Gjirokaster.

Zerat e rradhitur ne kete specifikim, perkojne me zerat e preventivuar, mbeshtetur ne projektin e hartuar dhe ne "Manualet teknike te cmimeve te ndertimit dhe analizat teknike te tyre" te miratuar nga K.M i Republikes se Shqiperise me vendimin nr 568 date 27.6.2013.

Standartet e cilesise se materialeve te perdorura jane , ato te shtetit Shqiptar per materialet prodhim vendi dhe ato te vendeve te Bashkimit European per materialet e importit. Ne keto raste Administratori i kontrates vec certifikates se origjines mund te kerkoje dhe certifikat e cilesise dhe te dhenat per performancen teknike te artikujve qe do te furnizohen.

Standartet e perdorura ne kete specifikim teknik , nuk jane mbeshtetur vetem ne vizatimet e projektit , kushtet teknike te projektimit dhe te zbatimit ,por edhe ne manualet ligjore dhe ne libra te tjera.

Keto specifikime teknike, theksuam qe jane hartuar enkas per "Rikonstrukcionin e hapsires publike dhe rrugen hyrese prane "Memorialit te Rilindasve" Gjirokaster dhe nuk mund te perdoren per objekte te tjera.

Subjeketi i perfshire ne hartimin e ketij rikonstrukcioni, ne rast problemi, mund te beje sugjerime, permiresime dhe plotesime te ketyre specifikimeve, ne se kerkohet nga ndryshime te mundshme te kategorive te punimeve ose mungesa e detajeve dhe e materialeve.

TE PERGJITHESHME

Paragrafet ne kete kapitull jane plotesuese te detajeve te dhena ne Kushtet e Kontrates dhe i sherbejne kontraktorit per fazen e pergatitjes se ofertes dhe supervizorit gjate fazes se zbatimit. Kontraktori dhe supervizioni duhet te kene parasysh qe :

1. Zevendesimi i materialeve te specifikuara ne Dokumentin e Kontrates do te behet vetem me aprovimin e Supervizorit ne se materiali i propozuar per tu zevendesuar eshte i njejte ose me i mire se materialet e specifikuara; ose ne se materialet e specifikuara nuk mund te sillen ne sheshin e ndertimit ne kohe per te perfunduar punimet e Kontrates, per shkak te kushteve jashte kontrollit te Kontraktorit. Qe kjo te merret ne konsiderate, kerkesa per zevendesim do te shoqerohet me nje dokument-deshmi te cilesise, ne formen e kuotimit te certifikuar dhe te dates se garancise te dorezimit nga furnizuesit e te dy materialeve, si te materialit te specifikuar ashtu edhe te atij qe propozohet te ndryshohet.

2. Kontraktori do te verifikojte te gjitha dimensionet, sasite dhe detajet te treguar ne Vizatimet, Grafiket,ose te dhena te tjera dhe Punedhenesi nuk do te mbaje pergjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to. Moszbulimi ose korrigjimi i



gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtësoje Kontraktorin nga pergjegjesia per pune te pakenaqeshme .Kontraktori do te marre persiper te gjithë pergjegjesine ne berjen e llogaritjeve te madhesive , llojeve dhe sasive te materjaleve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga Punedhenesi ne se gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

3. Kontraktorit nuk do te behet asnje **pagese** mbi cmimet njesi te kuotuar per kostot e mobilizimit d.m.th. per sigurimin e transportit, drite, energjine ,veglat dhe pajisjet,ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertimit,rrugeve te hyrjes,te komoditeteve sanitare heqje e mbeturinave, punen, furnizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme, pajisje dhe materjale, ose per kujdesin mjeksor dhe mbrojtjen e shendetit, ose per patrullat dhe rojet, ose per ndonje sherbim tjetër, lehtësi, gjera, ose materjale te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate.

4.Kontraktori te organizoje punen per ndertimin, mirembajen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose cdo rruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e punimeve . Cvendosja do te perfshije pershtatjen e zones me cdo rruge hyrje dhe se paku me shkalle sigurie,qendrushmerie dhe te kullimit te ujrave siperfaqesore te njejte me ate qe ekzistonte perpara se Kontraktori te hynte ne Shesh.

5. Kontraktori ujin qe nevojitet per zbatimin e punimeve do te merret nga rrjeti kryesor nepermjet nje matesi ne piken me te afert te mundeshme.Kontraktori do te shtrije rrjetin e vet te perkoheshem te tubacioneve . Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot per kete do te pagohen nga Kontraktori. Ne rastet kur nuk ka mundesi lidhje me rjetin kryesor, Kontraktori duhet te beje vete perpjekjet per furnizimin me uje higjenikisht te paster dhe te pijshem per punetoret dhe punimet.

6. Kontraktori do te beje perpjekjet dhe me shpenzimet e tij per furnizimin me energji elektrike ne kantjer, si me kontraktim me KESH – in , kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal jane te mundura , ose duke parashikuar gjeneratorin e vet per te permbushur kerkesat.

7. Kontraktori, me shpenzimet e tij duhet te beje ndertimin e modinave dhe te piketave siç kerkohet, ne perputhje me informacionin baze te Punedhenesit,dhe do te jete pergjegjesi i vetem per perpikmerine. Kontraktori do te jete pergjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe i eshte dhene dhe ne asnje menyre nuk do te lehtësohet nga pergjegjesia e tij ne se nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik ose jo korrekt .Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhenesi ,dhe ne asnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshime ne vizatimet e kontrates , per asnje lloj kompensimi per korrigjimet e gabimeve ose te mangesive .Kontraktori do te furnizojë dhe mirembaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale te tjera te tilla dhe te jape asistenca nepermjet nje stafi te kualifikuar siç mund te kerkohet nga Punedhenesi per kontrollin e modinave dhe piketave.



8. Kontraktori do te ruaje te gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, te bera ose te vendosura gjate punes, te mbuloje koston e rivendosjes se tyre nese ato demtohen dhe te mbuloje te gjitha shpenzimet per ndreqjen e punes se bere jo mire per shkak te mosmirembajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim te ketyre pikave te vendosura, modinave dhe piketave.

Perpara cdo aktiviteti ndertimor, Kontraktori do te kete linjat e furnizimit me uje dhe energji elektrike te vendosura ne terren, te drejten e kalimit te qarte dhe te sheshuar, gati per fillimin e punimeve. Çdo pune e bere jasht akseve, kuotave dhe kufijve te treguara ne vizatime ose te mosmiratuara nga Punedhnesi nuk do te paguhet, dhe Kontraktori do te mbuloje me shpenzimet e tij germimet shtese gjithmone nen drejtimin e Supervizorit.

9. Kontraktori duhet te beje forografi me ngjyra sips udhezimeve te Supervizorit ne vendet e punes per te demonstruar kushtet e sheshit perpara fillimit , progresin gjate punes se ndertimit dhe mbas perfundimit te punimeve. Nuk do te behen pagesa per fotografimin e kantierit te punimeve pasi keto shpenzime jane parashikuar te mbulohen nen koston administartive te Kontraktorit.

10. Kontraktori duhet te kete vecanerisht kujdes ne:

- a) nevojen per te mirembajtur sherbimet ekzistuese dhe mundesite e kalimit per banoret dhe tregetaret qe jane ne zone gjate periudhes se ndertimit.
- b) prezencen e mundeshme te kontraktoreve te tjere ne zone me te cilet do te koordinohet puna.

E gjithe puna do te behet ne nje menyre te tille qe te lejoje hyrjen dhe perballimin e te gjithe pajisjeve te mundeshme per ndonje Kontraktor tjeter dhe punetoreve te tij, stafin e Punedhnesit si edhe te cdo punojnjesi qe mund te punesohet ne zbatim dhe/ose punimet ne zone ose prane saj per cdo objekt qe ka lidhje me Kontraten ose cdo gje tjeter.

Ne pregatitjen e programit te tij te punes Kontraktori gjate gjithe kohes do te beje llogari te plote dhe do te koeporoje me programin e punes se Kontraktoreve te tjere ne menyre qe te shkaktoje nje minimum interference me ta dhe me publikun. Nga Punedhnesi rekomandohet qe punetoret e pakualifikuar te merren nga zona.

11. Kontraktori do te mare masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesuar dhe te jetes publike si edhe te pasurive ne dhe rreth sheshit te ndertimit. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikushme, kodeve te ndertesave dhe te ndertimit do te respektohen. Makinerite, pajisjet dhe cdo rrezik do te kqyren ose eliminohen ne perputhje me masat paraprake te sigurimit.

12. Kontraktori, gjate zbatimit te punimeve me shpenzimet e veta, duhet te vendosi dhe te mirembaje gjate nates pengesa te tilla dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidentet. Kontraktori duhet te siguroje pengesa te pershtateshme, shenja me drite te kuqe "rrezik" ose "kujdes" dhe vrojtues ne te gjitha vendet ku punimet mund te shkaktojne crregullime te trafikut normal ose qe perbejne ne ndonje menyre rrezik per publikun.



13. Kontraktori, me shpenzimet e veta, duhet te ndermarre te gjitha veprimet e mundshme per te siguruar qe ambjenti lokal i sheshit te ruhet dhe qe vijat e ujit, toka dhe ajri (duke perfshire edhe zhurmat) te jene te pastra nga ndotja per shkak te punimeve te kryera . Mos plotesimi i kesaj klauzole ne baze te evidentimit nga Supervizori, mund te coje ne nderprerjen e kontrates.

14. Kontraktori transportin e cdo materiali nga kavot, nyjet apo magazinat e ndryshme, do ta beje me makina te pershtateshme te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjitha ngarkesa te jete e siguruar. Ndonje makine qe nuk ploteson kete kerkese ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do te hiqet nga kantjeri. Te gjitha materialet ,duhet te stivohen ose te magazinohen ne menyre te pershtateshme per ti mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe ne dispozicion per tu kontrolluar nga Supervizori ne cdo kohe.

15. Kontraktori duhet te beje me shpenzimet e tij, te marre me qira ose te blerje nje terren te mjaftueshem per ngritjen e magazinave dhe zyrave te tij dhe per krijimin e nje zyre per Supervizorin siç eshte specifikuar, te gjitha keto me shpenzimet e tij.

16. Kontraktori duhet te pergatise vizatimet per te gjitha punimet “siç jane faktikisht zbatuar” ne terren. Vizatimet do te behen ne nje standart te ngjashem me ate te vizatimeve te Kontrates.

Gjate zbatimit te punimeve ne kantier, Kontraktori do te ruaje te gjitha informacionin e nevojshem per pergatitjen e “Vizatim siç eshte zbatuar”. Do te shenoje ne menyre te qarte vizatimet dhe te gjitha dokumentet e tjera, te cilat mbulojne punen e vazhdueshme te perfunduar, material i cili do te jete i disponueshem ne cdo kohe gjate zbatimit per Supervizorin. Keto vizatime do te azhurnohen ne menyre te vazhdueshme dhe do ti dorezohen Supervizorit cdo muaj per aprovim, pasi Punimet te kene perfunduar, sebashku me kopjen perfundimtare. Materiali mujor do te dorezohet ne kopje leter.

Vizatimet e riprodhuara do te perfshijne pozicionin dhe shtrirjen e te gjitha konstruksioneve mbajtese te lena gjate germimeve dhe vendosjen ekzakte te te gjitha sherbimeve qe jane ndeshur gjate ndertimit. Kontraktori, gjithashtu duhet te pergatise seksionet e profilit gjatesor te rishikuar, pajisur me shenimet qe tregojne shtresat e tokes qe hasen gjate te gjitha punimeve te germimit.

Si perfundim, kopjet e riprodhuara te Vizatimeve “ siç eshte zbatuar” do t’i dorezohen Supervizorit per aprovim. Vizatimet “siç eshte zbatuar” ,te aprovuara, do te behen prone e Punedhenesit.

Nuk do te behen pagesa per berjen e Vizatimeve “siç eshte zbatuar” dhe Manualeve, pasi kosto e tyre eshte parashikuar te mbulohet nga shpenzimet administrative te Kontraktorit.

Vizatimet duhet te printohen ne format A0, A1, A2, A3 dhe t’i dorezohen Investitorit ne 3 kopje.

17. Kontraktori ne perfundim te punes, sa here qe eshte e aplikueshme, me shpenzimet e tij, duhet te pastroje dhe te heqe nga sheshi te gjitha impiantet ndertimore, materialet qe kane tepruar, mbeturinat, skelerite dhe ndertimet e perkoheshme te cdo lloji dhe te lere sheshin e tere dhe veprat te pastra dhe ne kondita te pranueshme. Pagesa



perfundimtare e Kontrates do te mbahet deri sa kjo te realizohet dhe pasi te jepet miratimi nga Supervizori.

1. PUNIME PRISHJE

1.1. Prishje totale e ndertese pa rikuperim materialesh perfshin :

1.1.1. Prishjen e tere ndertesese ose nje pjese e saj me cdo lloj mjeti dhe , perfshire: tere masat per , puntelimet, skelat e sherbimit, marrjen e masave per aplikimin e te gjitha akteve perkatese te sigurise se mbrojtjes se punetoreve ,pasurise dhe jeten e komunitetit dhe kalimtareve.

1.1.2. Sinjalet per ditën e naten si dhe personelin per lajmerimin e kalimtareve,

1.1.3. Punimet per rrethimet e perkohshme,

1.1.4 Riparimin per demet e mundshme qe mund t'u shkaktohen te treteve dhe restaurimi i tubacioneve publike dhe private,

1.1.5. Ngarkimin e materialeve qe rezultojne nga prishja, perfshire transportin dhe shkarkimin.

1.1.6. Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

1.2. Prishje me zgjedhje te materialit per riperdorim perfshin:

1.2.1. Tere kerkesat e mesiperme te pershkruara ne 1.1.

1.2.2. Zgjedhjen per ruajtje dhe pastrimin e materialeve te rperdorshme qe rezultojne nga prishja.

1.2.3. Stivimin e materialeve brenda kantjerit, ngarkimin transportin deri ne magazinat e investitorit dhe shkarkimin.

1.2.4.Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

1.3. Prishje muratures se tulates perfshin :

1.3.1. Percaktimin dhe perdorurimi e mjetet e pershtatshme, ne varesi te mases qe do priset.

1.3.2.Pprishjen e suvatimit, veshjes se cfaredo forme, qe jane realizuar ne murin qe priset, pamvaresisht nga trashesia e tyre,

1.3.3. Skelen e sherbimit ose skelerine, armaturat e nevojshme per te mbeshtetur ose mbrojtur strukturat ose ndertesat pereth,

1.3.4.Riparimin per demet e shkaktuara ndaj te treteve per nderprerjet dhe ristaurimin normal te tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave te zeza, ujin, dritat etj.), duke perfshire transportin e tere materialeve qe rezultojne nga prishja ne nje vend te autorizuar publik.

1.3.5.Spostimin e materialit brenda ambjentit te kantjerit, si dhe cdo detyrim tjeter per perfundimin e punes ne menyre perfekte.



1.3.6. Kur kerkohet rikuperimi i tullave behet dhe pastrami, stivimin e tyre per ruajtje kur do te riperdoren ose te dorezohen ne magazimat e investitorit.

1.3.7. Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

1.4. Prishje murit te gurit perfshin :

1.4.1. Percaktimin dhe perdorimi e mjetet e pershtatshme, ne varesi te mases qe do priset.

1.4.2. Prishjen e suvatimit, veshjes se cfaredo forme, qe jane realizuar ne murin qe priset, pamvaresisht nga trashesia e tyre,

1.4.3. Skelen e sherbimit ose skelerine, armaturat e nevojshme per te mbeshtetur ose mbrojtur strukturat ose ndertesat pereth,

1.4.4. Riparimin per demet e shkaktuara ndaj te treteve per nderprerjet dhe ristaurimin normal te tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave te zeza, ujin, dritat etj.), duke perfshire transportin e tere materialeve qe rezultojne nga prishja ne nje vend te autorizuar publik.

1.4.5. Spostimin e materialit brenda ambjentit te kantjerit, si dhe cdo detyrim tjeter per perfundimin e punes ne menyre perfekte.

1.4.6. Kur kerkohet rikuperimi i gureve, behet dhe pastrami, stivimin e tyre per ruajtje kur do te riperdoren ose te dorezohen ne magazimat e investitorit.

1.4.7. Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

1.5. Prishje e strukturave beton parashikon:

1.5.1. *Prishje totale ose e pjesshme e strukturave te betonit vertikale ose horizontale, me shume se 5 cm te trasha, duke perdorur cdo mjet, perfshire puntelimet, marrjen e masave per aplikimin e te gjithe akteve perkatëse te sigurise se mbrojtjes se punetoreve dhe popullise, sinjalet e dites e te nates si dhe personelin per lajmerimin e kalimtareve, punimet per rrethimet e perkohshme, riparimin per demet e mundshme qe mund t'u shkaktohen te treteve dhe ristaurimi i tubacioneve publike dhe private, duke perfshire ngarkimin e materialeve qe rezulton nga prishja dhe transportin per shkarkim.*

1.5.2. Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

1.6. Heqje e srtukturave beton arme parashikon:

1.6.1. Heqje e strukturave beton arme ose e pjesëve te tyre, duke perdorur paisje mekanike, perfshire nje prishje te pjesshme per te zvogeluar volumin dhe peshen e blloqeve, perfshire puntelimet, marrjen e masave per aplikimin e te gjithe akteve perkatëse te sigurise se mbrojtjes se punetoreve dhe popullise, sinjalet e dites e te nates si dhe personelin per lajmerimin e kalimtareve, punimet per rrethimet e perkohshme, riparimin per demet e mundshme qe mund t'u shkaktohen te treteve dhe ristaurimi i tubacioneve publike dhe private, duke perfshire ngarkimin e materialeve qe rezulton nga prishja dhe transportin per shkarkim.



1.6.2. Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

1.7. Prishje e suvatimit parashikon:

1.7.1. Goditje e te gjithe siperfaqes se suvatuar dhe gjetje e pjesëve te mufatura dhe të plasaritura nepermjet tingullit, prishjen e ketyre pjesëve deri në daljen e muraturës, ne mure dhe tavane, larje e siperfaqeve te prishura me uje me presion, duke perfshire skelat e sherbimit ose skelerine , spostimin e materialit qe rezulton brenda ambientit te kantierit si dhe çdo detyrim tjetër per ti dhene plotesisht fund heqjes së suvasë.

1.7.2. Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

1.8. Shqepja e shtresave me pllaka gjithëfaresh , perfshin:

1.8.1. Heqjen totale te shtresave me pllaka te te gjitha llojeve dhe permasave apo te pjeseve te demtuar, ashtu siç parashikohet ne preventi.,

1.8.2. Heqjen e shtreses se poshtme te llacit, me te cilin jane fiksuar keto pllaka, pamvaresisht nga trashesia dhe nxjerjen e tyre jashte objektit per ne piken e ngarkimit.

1.8.3. Cdo detyrim tjetër per mbarimin e plote e te sigurte te shqepjes ne menyre perfekte.

1.8.4. Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

1.9. Shqepje bazamakeve te shkalleve me materile te ndryshme perfshin:

1.9.1. Heqjen e kembe shkeljeve dhe pjeseve vertikale le prej granili te derdhu, me gure e blloqe guri, me bazamak granili apo mermeri, ndarjen dhe magazinimin e pjeseve qe mund te riperdoren dhe largimi per ne piken e grumbullimit te mbeturinave pas prishjes dhe garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Kontraktori duhet te kete parasysh se demtimi i murebe gjate heqje se davancaleve ekzistuese eshte ne ngarkim te tij.

1.9.2. Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

2. PUNIME DHEU

Puna qe mbulohet nga ky kapitull i specifikimeve konsiton ne furnizimin e gjithe kantierit, puneve, pajisjeve, veglave dhe materialeve qe kerkohen per kryerjen e te gjithe puneve ne lidhje me germimin, hapjen e kanaleve dhe shtresimin e rrugeve, linjave te ujit, linjave te kanalizimit, strukturave te drenazhimit dhe aksesoret, ne perputhje te plote me specifikimet e ketij kapitulli dhe vizatimet e zbatueshme, qe jane subjektit i termave dhe Kushteve te Kontrates; perfshihen:

2.1. Te gjitha germimet te cfaredo lloji dheu qe ndeshen do te kryhen ne thellesine dhe gjeresine e percaktuar, siç percaktohet ne vizatimet dhe/ ose siç percaktohet me



shkrim nga Supervizori. Gjate germimit materiali i pershtatshem per mbushje do te grumbullohet ne nje vend te pershtatshem, ne nje distance te mjaftueshme nga bankinat, per te shmangur mbingarkimin dhe t'i ruaje nga shembja anet e kanalit. Shtresa e siperme e tokes do te grumbullohet vecas per nje riperdorim te mevonshem nese eshte e nevojeshme. I gjithe materiali jo i pershtatshem ose qe nuk kerkohej per veshje do te cohet ne nje vend te aprovuar nga Punedhenesi. Germimi ne rruget do te behet ne menyre te tille qe pasazhi i rruges te mos bllokohet nga materiali i germimit. Nivelimi do te behet ne menyre te tille, nese eshte e nevojeshme, per te ruajtur qe uji siperfaqesor te mos vershohet ne kanale ose ne pjese te tjera te germuara .Cdo sasi uji e mbledhur do te hiqet me ane te pompave ose me metoda te tjera te aprovuara, me koston e vete Kontraktorit.

2.2. Eshte parashikuar, qe te gjithe punimet e germimit ne kete kontrate do te jene gërmim dheu. Termi “dhe” ,siç eshte perdorur ketu do te perfshije te gjitha materialet ,te cilat sipas mendimit te Punedhenesit nuk kerkojne shperthim, heqje ose copetim te materialit, per cvendosjen nga shtrati i tij origjinal.

Materialet e dobeta ose pjese te buta, qe ne menyre natyrale ndeshen ne fund te ndonje germimi, do te hiqen me dore dhe do te largohen dhe keto gropa qe krijohen do te mbushen me nje material te pershtatshem ose beton, siç do te udhezohet nga Supervizori. Kjo pune do te matet dhe paguhet me cmimet njesi te aplikueshme. Kerkohen masa dhe baraci qe shendetin dhe jeten per punonjesit qe kryejne keto punime, per kalimtarete dhe per komunitetin.

2.3. Te gjitha sheshet ku do te germohet, do te pastrohen nga te gjitha shkurret, bimet, ferrat, rrenjet e medha, plehrat dhe materiale te tjera siperfaqesore. Te gjithe keto materiale do te spostohen dhe largohen ne menyre qe te jete e pelqyeshme per Punedhenesin.

2.4. Te gjitha pemet dhe shkurret e pecaktuara nga Punedhenesi qe do te mbeten, do te mbrohen dhe ruhen ne menyren e aprovuar.

2.5.Te gjitha strukturat ekzistuese te identifikuara per tu prishur, do te largohen sipas udhezimeve te Supervizorit. Kjo do te perfshije dhe spostimin e themeleve te ndertimeve, qe mund te ndeshen.

2.6. Kontraktori do te marre te gjitha masat e nevojeshme per mbrojtjen e vijave ekzistuese te ujit, rrethimeve dhe sherbimeve, qe do te mbeten ne sheshin e ndertimit. Kosto e pastrimit te kantierit eshte e detyrueshme te paguhet brenda cmimit njesi per punimet e germimit .

2.7. Kanalet do te germohen ne dimensionet dhe nivelin e treguar ne vizatime dhe /ose ne perputhje me instruksionet me shkrim te Supervizorit. Zeri i treguar ne tabelen e Volumeve (Preventiv) lidhur me germimet ,siç eshte largimi i materialit te germuar, etj. do te perfshije cdo lloj kategorie dheu, nese nuk do te jete specifikuar ndryshe. Ne rastin kur perdoren tubat shtese dhe me gota, germimi me dore i materialit te shtratit eshte i nevojshem per cdo bashkim. Germimi me krahe eshte gjithashtu i nevojshem ne afersi te



intersektimeve te infrastrukturave te tjera, per te parandaluar demtimin e tyre. Me perjashtim te vendeve te permendura me siper , mund te perdoren makinerite.

Ne se nuk urdherohet apo lejohet ndryshe nga Supervizori, nuk duhet te hapen me shume se 30 metra kanal perpara perfundimit te shtrirjes se tubacionit ne kete pjese kanali. Gjeresia dhe thellesia e kanaleve te tubacioneve do te jete siç eshte percaktuar ne vizatimet e kontrates ,ose siç do te udhezohet nga Supervizori

Thellimet per pjeset lidhese do te germohen me dore ,mbasi fundi i kanalit te jete niveluar. Pervec se kur kerkohet ndryshe, kanalet per tubacionet do te germohen nen nivelin e pjeses se poshteme te tubacionit ,siç tregohet ne vizatime, per te bere te mundur realizimin e shtratit te tubacioneve me material te granular. Kerkohen masa dhe baraci qe shendetin dhe jeten per punonjesit qe kryejne keto punime, per kalimtarete dhe per komunitetin.

2.8. Germimet per strukturat te behen ne permasat dhe nivelin qe percaktohet ne vizatimet dhe / ose siç mund te instruktohet me shkrim nga Supervizori.

Kur niveli i bazamentit eshte arritur, Supervizori do te inspektojë dheun e tabanit dhe do te jape udhezime per germim te metejshem, nese ai e konsideron te nevojeshme. Germimi do te behet ne nje menyre te tille, qe te siguroje qe vepra do te qendroje ne nje bazament solid dhe shume te paster.

2.9. Germim me çekiç me ekskavator me zinxhir I shtresave betoni dhe te asfalti, ne rruget ekzistuese qe do te shtrohen me kalldrem parashikon;

Thyerjen e shtresave ekzistuese me asphalt apo beton, apo te dyja bashke , grumbullimi i materialit te coptuar dhe stokimi ne ne vend te pershtatshem per tru riperdorur si material mbushes ne rruge apo pas mureve mbajtes.

2.10. Germim per perforcim te themeleve, deri ne thellesine, gjeresine dhe largesine e dhene sipas udhezimeve ne projekt, ne terren te cfaredo natyre dhe konsistence, te thare ose te lagur (argjile edhe n.q.s. eshte kompakte, rere, zhavorr, gure etj.), perfshire prerjen dhe heqjen e rrenjeve, trugjeve, gureve dhe pjeseve me volum deri ne 0,30 m³, plotesimin e detyrimeve ne lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave te zeza, tubacionet ne pergjithesi etj., perforcimin e cfaredo marke dhe rezistence, mbushjen e pjeseve qe mbeten bosh pas perforcimit te themeleve me materialin e germimit te kryer me dore, si dhe spostimin e materialit qe rezulton brenda ambientit te kantierit.

2.10.1. Perforcime te themeleve, ne thellesi, gjeresi dhe gjatesi sipas udhezimeve ne projekt, realizuar me beton C12/15, me dozim per m³ sipas pikes 2.1, duke perfshire kallepet e mundshme, dhe cdo gje tjeter te nevojshme per ti dhene fund perforcimeve dhe per ti realizuar ne menyre perfekte.

2.10.2. Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

2.11. Punimet mbushje



2.11.1. Do te realizohen ne perputhje me permasat dhe nivelet qe tegohen ne vizatime dhe/ose siç percaktohen ndryshe me shkrim nga Supervizori. Punimet do te realizohen ne nivelin qe te kenaqin kerkesat e Supervizorit.

Materialet ,qe do te perdoren per punimet mbushese, do te jene te lira nga gure dhe pjese te forta me te medha se 75 mm ne cdo permase dhe gjithashtu, te paster nga perberesa druri apo mbeturina te cdo lloji. Materiali mbushes do te ngjeshet sipas menyres se aprovuar.

2.11.2.Kanalet dhe shpatet, transhete dhe mbushjet e rrugeve do te ngjeshen, gjithashtu. Nese nuk specifikohet ndryshe apo kerkohet ndryshe nga Supervizori, materiali mbushes dhe mbulues do te merret nga punimet e germimeve. Nese Supervizori percakton se materiali nuk eshte i cilesise se duhur, atehere do te perdoret material i zgjedhur, i sjelle nga nje zone tjeter. Materiali i zgjedhur do te jete homogjen dhe do t'i kushtohet rendesi pastrimit nga llumrat, boshlleqet dhe cdo parregullesi tjeter.

2.11.3. Mbushjet dhe mbulimet do te jene ne shtresezime te vashdushme dhe gati horizontale, per te arritur trashesine e treguar ne vizatime ose siç mund te kushtezohet nga Supervizori.

2.11.4. Shtresa e siperme e fundit e mbushjes dhe e mbulimit duhet te mbahet ne gjendje sa me te sheshte te jete e mundur. Ne vendet ku kerkohet mbushje ose mbulim shtese, lartesia e treguar ne vizatime per mbushje dhe mbulim do te rritet ne perputhje me udhezimet e dhena.

2.12. Mbushja me argjile

2.12.1. Relizohet pas mureve mbajtes, materiali do te perhapet ne shtresa horizontale dhe trashesia e cdo shtrese nuk do te jete me shume se 15 cm. Operacionet e germimi dhe shperndarjes do te kryhen ne menyre te tille qe te jene perzjere dhe ngjeshur mire , dhe keshtu do te arrihet nje ngjeshje ne parametrat e kerkuar te papershkueshmerise dhe fortesise. Materiali qe do te ngjeshet, do te kete lageshtine e nevojshme, ne nivelin e pranuar nga Supervizori dhe do te mbahet i tille perpara dhe pas procesit te ngjeshjes. Lageshtia do te jete e njejte per cdo shtrese dhe ne çdo pike.

1.12.2. Lagia e materialit do te behet ne vendin e germimit, ne menyre sa me praktike dhe sipas percaktimit te Supervizorit. Megjithate, nese kerkohet njomje, mund qe ajo te realizohet edhe gjate ngjeshjes. Nese lageshtia e materialit eshte me e vogel se ajo e kerkuar per ngjeshje.

1.12.3. Kontraktori nuk do te vazhdoje me procesin e ngjeshjes pa marre me pare aprovimin e Supervizorit.

1.12.4.Nese lageshtia e materialit eshte me e madhe se optimumi i kerkuar, atehere do te pritet tharja e materialit ne parametrat e kerkuar ,dhe pastaj do te vazhdohet me ngjeshjen.

1.12.5.Per aq kohe sa Kontraktori do te vonoje punimet per efekt te tharjes se materialit, ai nuk do te kete korigjim te cmimit per kete arsye.

1.12.6. Pasi materiali mbushes eshte pergatitur ne menyre te pershtatshme dhe sipas kushteve te pershkruara ketu, me miratimin e Supervizorit, do te vazhdohet me ngjeshjen me cdo mjet te pershtatshem qe lejon te arrihet densiteti i kerkuar i ngjeshjes.

2.10. Nese pas pergatitjes se tabanit te themelit apo kanalit i priset nje pjese e ketij bazamenti , kontraktori duhet t'a permiresoje kete me shpenzimet e tij dhe me



pelqimin e Supervizorit. Kerkohen masa dhe garaci qe shendetin dhe jeten per punonjesit qe kryejne keto punime, per kalimtarete dhe per komunitetin.

2.11. Te gjitha germimet do te mirembahen sic duhet, nderkohe qe ato jane te hapura dhe te ekspozuara, si gjate dites ashtu edhe gjate nates. Pengesa te mjaftueshme, drita paralajmeruese, shenja, si edhe mjete te ngjashme do te sigurohen nga Kontraktori. Kontraktori do te jete pergjegjes per ndonje demtim personi ose pronesia per shkak te neglizhences se tij.

2.12. *Kontraktori do te ndertoje te gjitha drenazhimet dhe do te realizoje kullimin me kanale kulluese , me pompim ose me kova, si edhe te gjitha punet e tjera te nevojeshme per te mbajtur pjesen e germuar te paster nga ujerat e zeza dhe nga ujera te jashtme gjate avancimit te punes dhe derisa puna e perfunduar te jete e siguruar nga demtimet. Kontraktori duhet te siguroje te gjitha pajisjet e pompimit per punimet e tharjes se ujit si edhe personelin operativ, energjine e te tjera dhe te gjitha keto pa kosto shtese per Punedhensesin. I gjitha uji i pompuar ose i drenazhuar nga vepra duhet te hiqet ne nje menyre te aprovueshme prej Supervizorit. Duhet te meren masa paraprake te nevojeshme kunder permbytjeve .*

2.13. *Punedhensesi mund te urdheroje me shkrim, qe ndonje ose te gjitha perforcimet dhe strukturat mbajtese te lihen ne vend, me qellim te masave paraprake per mbrojtjen nga demtimet te strukturave, te pronesive te tjera ose personave, nese keto struktura mbajtese jane shenuar ne vizatime ose te vendosura sipas udhezimeve, ose nga ndonje arsye tjeter. Nese lihen ne vend, keto struktura mbajtese do te priten ne lartesine sipas udhezimeve te Supervizorit. Strukturat mbajtese, qe mbeten ne vend do te shtrengohen mire dhe do te paguhen sipas vlerave qe do te bihet dakort reciprokisht ndermjet Kontraktorit dhe Punedhensesit ose sipas cmimit ne Oferte nqs eshte dhene, ose nga nje urdher ndryshimi me shkrim.*

2.14. *Kontraktori do te kete kujdes te vecante per sherbimet ekzistuese, qe jane nen siperfaqe, te cilat mund te ndeshen gjate zbatimit te punimeve dhe qe kerkojne kujdes te vecante per mbrojtjen e tyre , si tubat e kanalizimeve, tubat kryesore te ujesjellesit, kabllot elektrike, kabllot e telefonit, si dhe bazamentet e strukturave qe jane prane. Kontraktori do te jete pergjegjes per demtimin e ndonje prej sherbimeve ,si dhe duhet t'i riparoje me shpenzimet e tij, nese keto sherbime jane ose jo te paraqitura ne projekt.*

1.15. *Nese autoritetet perkatese pranojne te rregullojne vete ose nepermjett nje nenkontraktori te emeruar nga ai vete , demet e shkaktuara ne keto sherbime, Kontraktori do te rimbursuje te gjitha koston e nevojeshme per kete riparim, dhe ne se ai nuk ben nje gje te tille, keto kosto mund te zbriten nga çdo pagese qe Punedhensesi ka per t'i bere ose do t'i beje Kontraktorit ne vazhdim te punimeve.*

2.16. *I gjitha materiali i tepert i germuar nga Kontraktori do te largohet ne vendet e aprovuara. Kur eshte e nevojeshme te transportohet material mbi rruget*



ose vende te shtruara, Kontraktori duhet ta siguroje kete material nga derdhja ne rruge ose vende te shtruara.

2.17. Çmimi njesi i zerave te punes per germimet do te perfshijne, por nuk do te kufizohen, per germime ne te gjitha gjeresine dhe thellesine, me cdo mjet qe te jete i nevojshem, duke perfshire germime me dore, nen apo mbi nivelin e ujrave nentokesore, ose nivelin e ujrave siperfaqesore, perfshire perzierje dheu te cdo lloji, mbeshtetset, perforcimin ne te gjitha thellesite dhe gjeresite, me cdo lloj mjeti qe te jete nevoja, perfshire edhe germimet me dore. Gjithashtu, do te perfshije largimin e ujrave nentokesore dhe siperfaqesore ne cdo sasi dhe nga cdo thellesi, me cdo mjet te nevojshem, do te perfshije nivelimin, sheshimin, ngjeshjen e formacioneve, proven dhe cdo pune shtese per mbrojtjen e formacioneve perpara cdo inspektimi, siç specifikohet, largimin dhe grumbullimin e pemeve te hequra, rilevimin topografik te kerkuar, vendosjen e piketave te perhershme dhe te atyre te perkoheshme, realizimin e matjeve, sigurimin e instrumentave per tu perdorur nga Supervizori, furnizimin dhe transportin e fuqise puntore, mbajtjen e vendit te punes paster dhe ne kushte higjeno-sanitare, dhe cdo nevojje aksidentale te nevojshme per realizimin e Punimeve brenda periudhes se Kontrates dhe pelqimit te Supervizorit. Te gjitha llojet e transportit, perfshire edhe transportin e materialeve per perforcim, mbulim, pergatitjen e shtratit, etj., perfshihen ne cmimin njesi te germimit.

Nese nuk eshte pohuar ndryshe, te gjitha aktivitetet e tjera te pershkruara me siper do te konsiderohen te perfshira ne cmimin njesi te germimit.

2.18. Te gjitha zerat e germimeve do te maten ne volum. Matja e volumit te germimeve do te bazohet ne dimensionet e marra nga vizatimet, ne te cilat percaktohen permasat e germimeve. Çdo germim pertej limiteve te percaktuara ne keto vizatime, nuk do te paguhet, nese nuk percaktohet me pare me shkrim nga Supervizori. Megjithate, nese germimi eshte me pak se volumi i llogaritur nga vizatimet, do te paguhet volumi faktik i germimeve sipas matjeve faktike.

2.19. Kosto e germimeve qe do te behen duke tejkeluar permasat e percaktuara nga projekti ose siç jane kerkuar me shkrim nga Supervizori, do te mbulohet me shpenzimet e vete Kontraktorit. Per me teper, Kontraktori do te jete i detyruar, nese keshtu urdherohet nga Supervizori, te rimbushet germimet ekstra me dhe te ngjeshur dhe gure te thyer ose beton te varfer, si te paraqitet rasti, sipas instruksioneve te Supervizorit, pa perfituar pagesa ekstra ose kompensime per sa me siper.

3. PUNIME MURATURE

3.1. Themele butobetoni, zbatuar me beton dhe gure gelqeror ne raporte per m3: beton m-100 0.77 m3 dhe gure 0.37 m3, me dozim te betonit per m3 siç tregohet ne piken 2.1, duke perfshire kallepet, perforcimet dhe cdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e themeleve dhe realizimin e tyre ne menyre perfekte. Nje shtrese bitumi 3 mm e trashe ose dy shtresa bitumi te nxehte do te hidhen siper perpara fillimit te ndertimit te murit.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.



3.2. Murature guri

3.2.1. Me trashesi uniforme ose te ndryshueshme per punime te jashtme ose te brendshme, e formuar nga gur gelqeror te cilesise se larte, me dimensione te pershtatshme dhe llac bastard m-25, me dozim per m³: gure 1.05 m³, llac bastard 0.33 m³, 48kg cemento m-400, duke perfshire cdo mjeshteri e material per dhembet e lidhjes, hapjet, qoshet, degezimet, skelat e sherbimit ose skelerine si dhe cdo gje tjeter per ti dhene fund muratures dhe per ta realizuar ne menyre perfekte.

3.2.2. Per muret me grure te glendur parashikohet dhe glendja e gureve sic do te vendoset ne kantier.

3.2.3. Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

4. PUNIME BETONI E B/ARMEJE

4.1. Puna e mbuluar nga ky seksion i specifikimeve konsiston ne furnizimin e gjithë kantierit, punen, pajisjet, veglat dhe materialet, dhe kryerjen e te gjitha punimeve, ne lidhje me hedhjen, kujdesin, perfundimin e punes se betonit dhe hekurin e armimit, ne perputhje rigoroze me kete kapitull te specifikimeve dhe projekt -zbatimin.

4.2. Kontraktori ne fillim te zbatimit te Kontrates, duhet te paraqese per miratim tek Supervizori nje njoftim per metodat ,duke detajuar, ne lidhje me kerkesat e ketyre Specifikimeve, propozimet e tij per organizimin e aktiviteve te betonimit ne shesh (terren). Njoftimi i metodave do te perfshije ceshtjet e meposhtme:

1. Propozimin per njesine e certifikuar te prodhimit
2. Metodat e propozuara per organizimin e pajisjeve te ngjeshjes t te betonit
3. Procedurat e kontrollit te cilesise se betonit dhe materialeve te betonit
4. Transporti dhe hedhja e betonit
5. Detaje te punes se berjes se kallepeve, duke perfshire kohen e heqjes se kallepeve dhe procedurat per mbeshtetjen e perkohshme te trareve dhe te soletave.

4.3. Kontraktori do te punesoje inxhinier te kualifikuar, te specializuar dhe me eksperience, i cili do te jete pergjegjes per kontrollin e cilesise te te gjithë betonit. Materialet dhe mjeshteria e perdorur ne punimet e betonit duhet te jete e nje cilesie sa me te larte qe te jete e mundur, prandaj vetem personel me eksperience dhe aftesi te plote ne kete kategori punimesh do te punohesohet per punen qe perfshin ky seksion specifikimesh.



4.4. Perpara se te jete kryer ndonje proces i pergatitjes se llacit ose betonit, zona brenda armaturave (ose sipërfaqe te tjera sipas zbatimit) duhet te jete pastruar shume mire me uje ose me ajer te komprimuar. Çfaredo qe ka te beje me kete proces, duhet te pergatitet siç eshte specifikuar.

4.5. Asnje proces betonimi nuk duhet te kryhet derisa Supervizori te kete inspektuar dhe aprovuar (ne se eshte e mundur) germimin, masat e marra per mbrojtjen nga kushtet atmosferike, masat per shperndarjen e ujit per freskim dhe staxhionim, armaturat, ndalimin e ujit, fugat ndertimore dhe fiksimin e fundeve dhe masa te tjera, armimin dhe ceshtje te tjera qe duhet te fiksohen, si dhe te gjitha materialet e tjera per betonimin dhe masa te tjera ne pergjithesi.

Kontraktori duhet t'i jape Supervizorit njoftime te arsyeshme per te bere te mundur qe ky inspektim te kryhet.

4.6. Markat e betonit

Raportet e meposhtme per betonin, perdorur ne punimet e ndertimit dhe referuar zerave specifike, jane te vleshme per 1(nje) m³ volum beton me cemento te zakonshme Portland. Keto standarte bazohen ne broshuren "Projektimi i Betoneve te Zakonshme, K.T. 37-75", date Tirane - 1980 (Republika e Shqiperise - Ministria e Ndertimeve I.S.P.Nr. 1).

Beton marka C 7/10 me inerte, konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6:Cimento 300 kg 240 , rere e lare m³ 0,45 , granil m³ 0,70 , uje m³ 0,18.

Beton marka C 12/15 me inerte , konsistence 3-5 cm,granil deri 20 mm,rere e lare me modul 2,6:Cimento 400 kg 260 , rere e lare m³ 0,44 , granil m³ 0,70, uje m³ 0,18.

Beton marka 16/20 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm,rere e lare me modul 2,6: Cimento 400 kg 300 , rere e lare m³ 0,43 , granil m³ 0,69 , uje m³ 0,18.

Beton marka 20/25 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm,rere e lare me modul 2,6: Cimento 400 kg 370 , rere e lare m³ 0.43, granil m³ 0,69 , uje m³ 0,185.

Beton marka 25/30 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm,rere e lare me modul 2,6: Cimento 400 kg 465 , rere e lare m³ 0,38 , granil m³ 0,64 , uje m³ 0,195.

4.7. Betonet qe prodhohen ne kantier kerkojne :

4.7.1. Çimento Portland e Zakonshme do te perdoret me BS 12 ose ASTM C-150 Tipi II-te ose Tipi V-te. Kjo do te perdoret aty ku betoni nuk eshte ne kontakt me ujera te zeza, tub gazi ose ujerat nentokesore, ose cemento Portland Sulfate e Rezistueshme do te



perdoret me BS 4027. Kjo do te perdoret per strukturat e betoneve duke perfshire pusetat dhe te gjitha perkatesite e tjera ne kontakt me ujerat e zeza, tubin e gazit ose ujerat nentokesore.

4.7.1.1. Çimento duhet te shperndahet ne paketa originale, te shenuara te pa demtuara ,direkt nga fabrika dhe duhet te ruhet ne nje depo, dyshemeja e te cilit duhet te jete e ngritur te pakten 150mm nga toka. Nje sasi e mjaftueshme duhet mbajtur rezerve per te siguruar nje furnizim te vazhdueshem ne pune, ne menyre qe te sigurohet qe dergesat e ndryshme jane perdorur ne ate menyre siç jane shperndare. Çimentoja nuk duhet ruajtur ne kantier per me shume se tre muaj pa lejen e Supervizorit. Çdo lloj tjetër çimento, Perveç asaj qe eshte e parashikuar per perdorimin ne pune nuk duhet ruajtur ne depo te tilla.

4.7.1.2.E gjithe çimentoja duhet mbajtur e ajrosur mire dhe çdo lloj çimento, e cila ka filluar te ngurtesohet, ose ndryshe e demtuar apo e keqesuar, nuk duhet te perdoret. Fletet e analizave te fabrikave duhet te shoqerojne cdo dergese, duke vertetuar qe çimentoja, e cila shperndahet ne shesh ka qene e testuar dhe i ka plotesuar kerkesat e permendura me lart. Me te mberritur, çertifikatat e provave te tilla duhen ti kalohen per t'i aprovuar Supervizorit.

4.7.1.3. Çimentoja e perfituar nga pastrimi i thaseve te cimentos ose nga pastrimi i dyshemese, nuk do te perdoret. Kur udhezohet nga Supervizori, çimento e dyshimte duhet te ristetohet per humbjen e fortesise ne ngjeshje.

4.7.1.4. Çimento duhet te mbrohen ne cdo kohe nga demtuesit dhe ndotjet. Thaset e cimentos nuk duhet te lihen direkt mbi dysheme, por mbi shtresa druri apo pjese te ngritur trotuari ,per te lejuar keshtu qarkullimin efektiv te ajrit rreth e qark thaseve.

9.6. Skela metalike tubolare e tipit kavalet, e ndertuar sipas normave teknike ne fuqi, perfshire ngarkimet, shkarkimet, transportet, mbetjet, vendosjen ne veper, mberthimin, cmontimin etj., per nje lartesi deri ne 12 m, duke perfshire perforcimin me pahi, dhe te formuar nga derrasa me trashesi 5 cm , per nje rradhe te vetme te skeles dhe nenskeles, parmakun, telat e mbrojtjes dhe cdo gje tjeter te nevojshme per sigurine e punetorit. N.q.s. eshte e nevojshme rethimin e skelave te jashtme nga ana e rruges, me ane te llamarines se valezuar, te larta jo me pak se 2 m, duke perfshire firot, hapjet ne terren per mbeshtetjen e kembeve dhe fiksimin e tyre, gozhdimin dhe lidhjen e llamarinave ne kembet, ne bordet e poshtme dhe te siperme, per te gjitha kohezgatjen e skeles ne veper, cmontimin dhe heqjen ne fund te punes, duke perfshire shenjat e mundshme, tabelat dhe dritat.

9.7. Skele metalike tubolare, e montuar me tuba te rrumbullaket dhe lidhje, e ndertuar sipas normave teknike ne fuqi, perfshire ngarkimet, shkarkimet, transportet, mbetjet, vendosjen ne veper, mberthimin, cmontimin etj. per nje lartesi deri ne 12 m, duke perfshire forcimin me pahi te formuara nga derrasa me trashesi 5 cm, per nje radhe te vetme te skeles dhe nenskeles, parmakun, telat e mbrojtjes dhe cdo gje tjeter te nevojshme per sigurine e punetorit. N.q.s. eshte e nevojshme rethimin e skelave te jashtme nga rruga , me ane te llamarines se valezuar, te larta jo me pak se 2 m, duke perfshire firot, hapjet ne terren per mbeshtetjen e kembeve dhe fiksimin e tyre, gozhdimet dhe lidhjet e llamarinave ne kembet, venien ne bordet e poshtme dhe te siperme, per te gjitha kohezgatjen e skeles ne veper, cmontimin dhe heqjen ne fund te punes, duke perfshire shenjat e mundshme tabelat dhe dritat.

9.8. Skele derrase, e montuar me binare dhe derrasa, e ndertuar sipas normave teknike ne fuqi, perfshire ngarkimet, shkarkimet, transportet, mbetjet, vendosjen ne veper, mberthimin, cmontimin etj. per nje lartesi deri ne 12 m, duke perfshire forcimin me pahi te formuara nga derrasa me trashesi 5 cm, per nje radhe te vetme te skeles dhe nenskeles, parmakun, telat e mbrojtjes dhe cdo gje tjeter te nevojshme per sigurine e punetorit. N.q.s. eshte e nevojshme rethimin e skelave te jashtme nga rruga, me ane te llamarines se valezuar, te larta jo me pak se 2 m, duke perfshire firot, hapjet ne terren per mbeshtetjen e kembeve dhe fiksimin e tyre, gozhdimet dhe lidhjet e llamarinave ne kembet, venien ne bordet e poshtme dhe te siperme, per te gjitha kohezgatjen e skeles ne veper, cmontimin dhe heqjen ne fund te punes, duke perfshire shenjat e mundshme tabelat dhe dritat .

10. PUNIME SISTEMIMI



10.1. Nderimi i rrrugëve te brendshme parashikon:

10.1.1. Zbankim dhe për pastrimin e truallit te siperm, i kryer ne çfarëdo menyre, duke perfshire prerjen dhe largimin e pemeve, shkurreve, cungjeve, rrenjeve dhe heqjen e shkembijve ne siperfaqe, siç tregohet ne Planin e

Pergjithshem

Ekzekutim, ne çfarëdo menyre, i gërmimit per realizimin e nje themeli per bordurat e rrugëve dhe per kanalet anesore te kullimit 50x50 cm ne te dy anet e rrugës, duke perfshire realizimin e pjerresive dhe tubacioneve me tuba betoni me diameter 40 cm nen rrugë, per kullimin e ujrave aty ku eshte e nevojshme.

10.1.2. Ngjeshje me kujdes e siperfaqes se truallit perpara vendosjes se Shtresës se pare 15 cm me gure lumi dhe të Shtresës se dyte perfundimtare 10 cm me te gjithë perbërësit qe duhen per rrugët, te dyja te ngjeshura mire me rul.

10.1.3. Rruga perfundimtare do te profilohet me kujdes per kullimet anesore te ujrave, siç përshkruhet ne projekt.

10.1.4. Vendosje e bordurave parafabrikat ne secilen ane te rrugës, te vendosura mbi nje baze betoni M-150 te derdhur ne shtresa te vibruara mire, me dozim per m3 siç tregohet ne artikullin e mesiperem 4.a.4, duke lene ne çdo 5 m, nje hapësire te hapur prej 20 cm per kullimin e ujrave, duke perfshire te gjitha detyrimet e nevojshme per perfundimin e punes ne menyre perfekte.

10.1.5. Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

10.2. Kalldrem me gur bllok te zi ranor , te gurores se Beratit parashikon:

10.2.1. Guret e kalldremit me gur ranor te zi te kene permasat me gjeresi 20-22 gjatesia e ndryshme dhe trashesi 8-10-12 cm. Duke qene se kalldremet do te jene te gershetuar dhe me gurin e bardhe te gurores se Muzines Sarande, kontraktori para se te beje porosine duhet te perlllogarise sasite duke patru parasysh gjeresine e gurit. Prodhuesi duhet te beje furnizimin me paleta ku vec sasise te percaktohet sakte dhe trashesia e gurit. Montimi i gureve qe do te formojne kalldremin do te behet mbi nje shtrese rere te klare me trashesi 3 cm e cila nga ana e saj do te mbeshtetet mbi nje shtrese betony te varfer siç parashikohet ne project.

10.2.2. Cdo detyrim tjeter dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

10.2.3. Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

10.3. Kalldrem me gur te bardhe te gurores se Muzines Sarande, parashikon:

10.3.1. Guret e kalldremit me gur te bardhe, te kene permasat me gjeresi 20-22 gjatesia e ndryshme dhe trashesi 8-10-12 cm. Duke qene se kalldremet do te jene te gershetuar dhe me gurin e zi ranor te gororeve te Beratit, kontraktori para se te beje porosine paraprake ne gororen e Muzines qe te seleksionohen guret me trashesi te njejte dhe mandej te prorosise glendjen e tyre. Prodhuesi duhet te beje furnizimin me paleta ku vec sasise te percaktohet sakte dhe trashesia e gurit. Montimi i gureve qe do te



formojne kalldremin do te behet mbi nje shtrese rere te klare me trashesi 3 cm e cila nga ana e saj do te mbeshtetet mbi nje shtrese betony te varfer siç parashikohet ne project.

10.3.2. Cdo detyrim tjetër dhe mjeshteri për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

10.3.3. Garancinë për punë të sigurta për punonjësit pjesëmarrës në proces të kalimtareve dhe të komunitetit.

10.3.4. F.V bordure parafabrikuara për pemet parashikon:

10.3.4.1. germimin e dheu për themele deri në thellesinë 15 cm nga toka, për një gjeresi 20 cm; furnizim dhe vendosje në vepe të bordurës së parafabrikuar me permasa 8x25 cm.

10.3.4.2 Kuadrat mbrojtës i përparashikohet 100x100 brenda për brenda.

10.3.4.3.Bashkim të bordurave në qoshe me kënd 45 gradë.

10.3.4.4 Nxjerjen 5 cm të bordurës mbi pllaken e trouarit dhe mbeshtet poshtë në një shtresë Beton marka C 7/10 me inerte, konsistencë 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6:Cimento 300 kg 240 , rere e lare m³ 0,45 , granil m³ 0,70 , uje m³ 0,18. Me trashesi 6 cm.

10.3.4.5. Që shtresa e betonit C 7/10 të shtrohet mbi një shtresë me zhavorr lumi me trashesi 15 cm, të ngjeshur dhe të sheshuar mirë;

10.3.4.6. Ngjitjen, stukimin, pastrimin si dhe cdo detyrim tjetër dhe mjeshteri për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

10.3.4.7. Garancinë për punë të sigurta për punonjësit pjesëmarrës në proces të kalimtareve dhe të komunitetit.

10.3.5. Sistemim , nivelim dhe pasurim me 5 kg/m² humus , i sferfaqes anash rruges parashikon:

Pasurimin e sferfaqes që parashikohet e gjelberuar me 5 kg humus mali për një m² I shpërndarë, niveluar dhe ngjeshur me kujdes dhe cdo detyrim tjetër dhe mjeshteri për mbarimin e punës në mënyrë perfekte. garancinë për punë të sigurta për punonjësit pjesëmarrës në proces të kalimtareve dhe të komunitetit.

10.3.6. Mbjellje bari parashikon:

Mbjellje barti me 50 gram për m², trajtimin e tij deri sa të zejë perfundimisht, masat mbrojtëse që sferfaqia të mos demttohët nga kalimtarët dhe kafshët e ndacake, Garancinë për punë të sigurta për punonjësit pjesëmarrës në proces të kalimtareve dhe të komunitetit.

10.3.7. F.V. Fidane Lule dekorative prashikon:

Furnizimin e fidanit nga qendrat e rritjes së luleve, mbjelljen e saj, pasurimin e dheut me pleh organik dhe trajtimin e saj që të garantohet zënja, masat mbrojtëse që sferfaqia të mos demttohët nga kalimtarët dhe kafshët e ndacake.garancinë për punë të sigurta për punonjësit pjesëmarrës në proces të kalimtareve dhe të komunitetit.



11.NDRICIM RRUGOR.

11.1. Punimet elektrike parashikohen te zbatohetn bazuar ne kushtet teknike te projektimit dhe standartet e Republikes se Shqiperise (KTP, STASH) dhe per elementet te vecante te projektit qe nuk perfshihen ne to, tu referohet euronormave (EN, HD) dhe eurostandarteve sipas rekomandimeve te IEC, CEN/CENELEC ose te vendeve te Komunitetit Evropian (KE) si CEI (UNI), BS etc. Keto norma e standarte mund te gjinden prane DSC Tirane.

11.2. Materialet dhe aparatet qe duhet te perdoren ne ndertimin e impiantit duhet te kene te gjitha cilesite e fortesise, kohezgjatjes, izolimit dhe te funksionimit te mire; dhe duhet gjithashtu te jene te tilla qe ti rezistojne veprimeve mekanike, gerryese, termike dhe lageshtires per ato qe duhet te jene ne kontakt me te gjate punes. Gjithashtu, jane nen pergjegjesine e sipermarresit montimet dhe cmontimet perkatese te pjesëve te instalimit per realizimin e provave dhe verifikimeve.

11.3. Te gjitha aparatet, kuadrot, centralet e inkasuar, çelësat, butonat, prizat etj., duhet te vendosen në vepër nepermjet kutive te instaluara me Llaç çimentoje m-1:2, me dozim per m2: çimento 400 kg 527, rërë e lare m3 0.89 dhe uje, duke u kujdesur vecanerisht qe instalimi i kutive te mesiperme te behet rrafsh me murin ne lidhje me siperfaqet e suvatuara dhe të veshura, ne menyre qe te mos verifikohen dalje apo futje apo futje te teperte te ketyre kutive.

11.4. Tubat fleksibel te lehte sipas CEI 205 EN2221 qe kalojne ne mure dhe te rende sipas CEI 325 EN3341 q kalojnene dysheme , duhet te nderfuten ne kutite shperndarese dhe ato te celsave dhe prizave, qe ne asnje menyre te mos demtoje telat dhe kabllo qe hyne qe hyne ne to perfshire : tubin termoplastik elastik me diameter mm 16, 20, 32 etj., vetshuhes, i vendosur në vepër brenda kanaleve te parapergatitur,

.. duke perfshire te gjitha detyrimet e nevojshme per perfundimin e punes ne menyre perfekte.

.. Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process , te kalimtareve dhe te komunitetit.

11.5 Percjellesa e kabllo te tensinit te ulet parashikohen prej bakri ne korde elastike, i izoluar me material termoplastik, me seksion mm 1,5, 2,5, 10 etj, ndersa kabllo te tensionit te ulet jane te markave,NYM 300/500V sipas VDE 0250-204 , NYM 300/500V sipas VDE 0250-204 , H07 V-K ose R 450/750V sipas HD 21.3 , H07 V-K ose R 450/750V sipas HD 21.3 , H07 V-K ose R 450/750V sipas HD 21.3. H07 V-K ose R 450/750V sipas HD 21. Dhe H07 V-K ose R 450/750V sipas HD 21.3 percjelles bakri me shume fije me veshje PVC, ne te gjitha ngjyrat, shkallë izolimi 3, dhe i futur ne tubat fleksibel termoplastik duke perfshire çdo paisje, lidhezat, kordat e terheqjes, skelat e sherbimit dhe çdo gje tjeter te nevojshme ;

Percjelles katerpolare prej bakri ne korde elastike, i izoluar me material termoplastik, me seksion mm2, 4x4, 4x16 etj., duke perfshire çdo paisje, lidhezat, kordat e terheqjes, skelat e sherbimit dhe çdo gje tjeter te nevojshme ;duke perfshire te gjitha detyrimet e



nevojshme per perfundimin e punes ne menyre perfekte dhe garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process , te kalimtareve dhe te komunitetit.

11.6. Ndricimit rrugor parashikon:. Materialet dhe aparatet qe do të përdoren ne ndertimin e impiantit duhet te kene te gjitha cilesite e fortesise, kohezgjatjes, izolimit dhe të funksionimit te mire; dhe duhet gjithashtu te jene te tilla qe ti rezistojne veprimeve mekanike, gerryese, termike dhe lageshtires per ato qe duhet te jene ne kontakt me te gjate punes. Gjithashtu, jane nen pergjegjesine e sipermarresit montimet dhe cmontimet përkatëse te pjesëve te instalimit per realizimin e provave dhe të verifikimeve.

11.7. Kabllo te tensionit te ulet qe furnizojne ndricuwain nga rrjeti ekzistues jane te markave,NYM 300/500V sipas VDE 0250-204 ,

duke perfshire çdo paisje, lidhezat, kordat e terheqjes, skelat e sherbimit dhe çdo gjë tjetër te nevojshme; per perfundimin e punes ne menyre perfekte.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

11.8. FV shtylla metalike konike ndricimi H=9m PAICC-3F bashke me krah dy deges parashikon:

11.8.1. Germimin e dheu per gropen ku do te momtohet shtylla deri ne thellesine e projektit.

11.8.2. Centrimin e tubi pvc me diameter 25 cm dhe betonimin e plintit sipas permasave ne project, me Beton marka C 7/10 me inerte, konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6:Cimento 300 kg 240 , rere e lare m³ 0,45 , granil m³ 0,70 , uje m³ 0,18. Me trashesi 6 cm.15 cm nga toka, per nje gjeresi 20 cm;

11.8.3. Montimin e shtylles dhe te kraheve sipas percaktimeve mne project,

11.8.4. Montimin e bllokut te ushqimit ne shtylle (morseteri 3P+sig 16 A + kapak)

11.8.5. Montimin e ndricuesit led she shtrirje e percjellsit ushqyes bashke me sistemin e komandimit.

11.8.6. cdo detyrim tjetër dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

11.8.7. Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

11.9. FV elektroda tokezimi te xingoara 50x3 mm l=1.5m

11.9.1 Per tokerzimin e shtylles me nul te izoluar, mbrojtjen nga renia nen tension, realizohet nepermjet mbrojtjes se castit, mbrojtjes nga mbingarkesa dhe mbrojtjes diferenciale.

11.9.2. Perfshin paisjet per mbrojtjen, karakteristikat dhe metodikat e zgjedhjes, klasat e izolimit, detajet e montimit, dimensionet etj. te jene ne perputhje me EN dhe eurostandartin sipas rekomandimeve te IEC, CEN/CENELEC (EN 60898, IEC 898 - EN 60529, IEC598 - etj.) ose te vendeve te KE (si CEI 23-3, 23-18, 64-8, 70-1 etj. ose te ngjashme me to).



11.9.3. Duhet te kenage kushtet e KTP-se dhe te EIA/TIA-607 per telekomunikacionin. Ndersa mbrojtje nga shkarkesat atmosferike, respektojne te dhenat e buletinit metereologjik shumevjecar, lartesisë dhe vendndodhjes se objekti duke plotesuar kushtet e KTP-se dhe te EIA/TIA-607 per telekomunikacionin.

11.9.4. Parashikon lidhjen nga jashte , me ane te nje korde te zhveshur te vene ne terren ne nje thellesi prej cm 50, prej bakri, me fill tresh te paperkulshem, me permasat e duhura, me nje maje bakri me diameter mm 20, e ngulur ne terren dhe duke arritur me kulmin nje thellesi prej m 2, e kompletuar me nje rondele plumbi, dhe majen e nguljes komplet prej bakri. Sipas sigurise se tokes se shprehur $RT \leq 10 \Omega$, mund te jene te nevojshme nje ose disa maja te lidhura ndermjet tyre me nje korde te zhveshur prej bakri, ne fill tresh te paperkulshem.

Maja duhet te futet ne nje pus kontrolli (ndertuar me tulla të plota dhe Llaç bastard m-25), me permasa cm 30x30x30, me nje kapak prej betoni te armuar.
Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

11.10. FV pusete elektrike kontrolli 40x40x40 cm prashikon:

11.10.1. Germimin e dheu per gropen ku do te momtohet puseta deri ne thellesine e nevojshme

11.10.2. Centrimin e dhe fikzsimin e pusetes, me Beton marka C 7/10 me inerte, konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6:Cimento 300 kg 240 , rere e lare m3 0,45 , granil m3 0,70 , uje m3 0,18. Me trashesi 6 cm.15 cm nga toka, per nje gjeresi 20 cm;

11.10.3. Llidhjet e nevojshme te shtylles me elektrodën e tokezimit, mondimin e shkeputesit per matjen e rezistences,kontrolin faktik te rezistences.

11.10.4 Cdo detyrim tjeter dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

11.10.5. Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

12. UJESIELLSI I JASHEM

12.1.Linjat e jashtme per furnizimin e objketit me uje, jane linjat jashte objektit nga pika e lidhjes e percaktuar deri ne depozitat btenda objektit. Atom und te jene me tuba celikut ose me tubo HDPE -100

12.2. Me tubo celiku , per pune ne presion deri ne 25 bar duhet te jene konform DIN 2460/61 ose ISO 559., te lyerjet me boje ose veshjet e tubave per mbrotje kunder korrozionit.



12.2.1 Montimi tubave duhet te jete ne pershtatje me ISO 49. Te gjitha valvolat mbylleduhet te jene te nje kualiteti te larte, prej tunxhi . Spinotat, guarnicionet, duhet te jene prej tunxhi.

12.2.2. Hidrantet e zjarrit duhet te jene te llojit nentokesor ose mbitokesor, sipas specifikimeve te projektit.

12.2.3. Shkarkimet

12.2.4. Vendndodhja e shkarkimeve do te jepet ne Projektet, ose siç udhezohet nga Supervizori. Pozicionimi ekzakt do b percaktohet sipas topografrit dhe me aprovimin e Supervizorit. Te pakten 3 metra te tubit te shkarkimit, perfshire dhe valvolat e izolimit, te matura nga qendra e linjes se tubit, duhet qe te lyhen ne te njejten kohe si tubi i linjes dhe lidhjet e pershtatshme, ne menyre qe te mbrohen nga hyrja e materialeve te huaja. Gradienti minimal per tubat shkarkimeve duhet te jete 1%.

12.2.5. Kujdes i vecante duhet te kushtohet ne transportin dhe dorezimin e tubave dhe pjeseve, per te parandaluar ndonje demtim te mundshem. Te gjitha materialet duhet te jene te sigurta dhe te ankoruara mire gjate transportit. Tubat dhe pjeset speciale nuk duhen te hidhen ne toke pa kujdes, sidomos kur ato jane dhe te zgjidhur. Ne vendin e ruajtjes, zgjedhur nga Kontraktori afer zones se punimeve ,tubat dhe pjeset e tjera duhet te sistemohen dhe te ruhen me kujdes. Nje shtrat prej druri eshte mire qe te vendoset poshte tubave. Metoda e ruajtjes do te perdoret ajo qe ka percaktuar prodhuesi.

12.2.6. Perpara se te shtrihen, cdo tub duhet te kontrollohet ne menyre te kujdesshme per shenjatat e demtimeve te ndeshura, vecanerisht ne fundet e cdo tubi. Aty ku demtimi nuk eshte i shtrire, fundi i tubit mund te pritret dhe perdoret tubi i shkurtuar, ne varesi te rekomandimeve te prodhuesit. Çdo mangesi, demtime ose parregullsi te materialeve nuk do te pranohen.

Te gjitha papastertite ose substanca te huaja duhet te levizen nga pjesa e brendshme e tubit dhe e aksesoreve, perpara se ato te shtrihen ne kanal dhe ato duhet te ruhen te pastra gjate vendosjes, shtrirjes dhe bashkimit.

12.2.7. Prerja e tubave per futjen e valvulave, pajisjeve ose pjeset mbyltese duhet qe te jete ne kendet e drejta te aksit te tubit, pa demtime te tubit. Veglat prerese te aprovuara qe duhet te perdoren, te dezinjua vecanerisht per tipet e tubave qe do te priten dhe te perdoren nga punetore me eksperience.

12.2.8. Bashkimi i tubave kryhet ne perputhje me rekomandimet e fabrikes se prodhimit te tubave. Kujdes i vecante duhet te merret per parandalimin e papastertive ose plehrave nga hyrja ne hapesirat bashkuese. Kur shtrirja dhe bashkimi i tubave nuk eshte progresiv, fundet e hapura te tubave dhe aksesoret duhet te mbyllen nga mjete te aprovuara dhe nuk do te lejohet qe linja e ujsjellesit te kanalit te hyje ne rrjetin kryesor te ujesjellesit. Bashkimi i tubave kryesore te ujesjellesit dhe aksesoret nuk do te kryhet ne prezence te ujit ,ose kur ne opinionin e Supervizorit kushtet e kanalit jane te papershtatshme per kete lloj pune. Per bashkimet me flanaxha duhen perdorur guarnicione me flete me trashesi 3-5mm. Diametri i brendshem i guarnicionit duhet te jete



sa ai i tubit. Bashkimi i flanaxhes me bulona duhet te behet ne menyre te njetrajtshme (kryqazi), per te shmangur shtremberime.

12.2.9. Per saldimet e bashkimeve te tubave prej celiku duhet te zbatohen udhezimet e dhena ne pjesen II(saldimet). Saldimi i pjeseve te tubave brenda ne llogore ne stinen e veres duhet te behet ne kohen me te ftohte te 24 oreshit.

12.3. Tubat polietileni. HDPE -100.

12.3.1. Tubat polietilene duhet te prodhohen ne perputhje me DIN 8074/8075 ose ISO R161/1-1978. Tubacionet prej Polietileni (PE) te perdorur ne sistemin e furnizimit me uje te pijshem, jane te Tipit HDPE-100, per presione te ndryshme 6,10, bar, se bashku me bashkuesit dhe shtesa te tjera te nevojshme.

12.3.2. Keto tuba normalisht duhet te magazinohen ne menyre qe te mos demtohen nga dielli.

12.3.3 Perpara se te shtrihen, cdo tub duhet te kontrollohet ne menyre te kujdesshme per shenjat e demtimeve te ndeshura, vecanerisht ne fundet e cdo tubi. Aty ku demtimi nuk eshte i shtrire, fundi i tubit mund te pritret dhe perdoret tubi i shkurtuar, ne varesi te rekomandimeve te prodhuesit. Çdo mangesi, demtime ose parregullsi te materialeve nuk do te pranohen.

12.3.4. Te gjitha papastertite ose substanca te huaja duhet te levizen nga pjesa e brendshme e tubit dhe e aksesoreve, perpara se ato te shtrihen ne kanal dhe ato duhet te ruhen te pastra gjate vendosjes, shtrirjes dhe bashkimit.

12.3.5. Prerja e tubave per futjen e valvulave, pajisjeve ose pjeset mbyltese duhet qe te jete ne kendet e drejta te aksit te tubit, pa demtime te tubit. Veglat prerese te aprovuara qe duhet te perdoren, te dezinjuara vecanerisht per tipet e tubave qe do te priten dhe te perdoren nga punetore me eksperience.

12.3.6. Te gjithe tubat, pajisjet, pjeset speciale, valvulat, dhe hidrantatet duhet qe te ulen me kujdes ne kanal in e pergatitur, ne nje menyre te tille qe te parandaloje demtimin e tubave dhe perkatesite e tyre. Çdo material i demtuar nuk do te pranohet

12.3.7. Tubat HDPE bashkohen, me shkrirje ose me elektrofuzion. Elektrofuzioni mund te preferohet aty ku bashkimi me shkrirje eshte jopraktik per shkak te mungeses se hapësirës.

12.3.8. Tubat e polietilenit do te mbahen me kujdes gjate gjithë kohës së prodhimit, transportimit në vendin e punës dhe instalimit. Çdo tub do të inspektohet në mënyrë të kujdesshme sipas standarteve të kërkesave të specifikimit gjatë dorëzimit dhe përpara se të shtrihet. Asnjë tub i krisur, i thyer apo me difekt nuk do të perdoret në veper. Demtimi i pjesës fundore të tubave që sipas Supervisorit mund të shkaktoje lidhje difektoze, do të jete shkak i mjaftueshem për të hequr tubat e demtuar.



12.3.9. Tubat HDPE do te pastrohen plotesisht nga mbeturinat ne brendesi perpara se te instalohen per tu ngjitur. Te gjitha kontaktet siperfaqsores te bashkimeve do te mbahen te pastra deri sa te kete perfunduar bashkimi . Bashkime ekonomike arihen duke perdorur teknikat e bashkimit me fusion. Çdo tub do te inspektohet ne menyre te kujdesshme sipas standarteve te kerkesave te specifikimit gjate dorezimit dhe perpara se te shtrihet. Asnje tub i krisur, i thyer apo me difekt nuk do te perdoret ne veper. Demtimi i pjeses fundore te tubave qe sipas Supervisorit mund te shkaktoje lidhje difektoze, do te jete shkak i mjaftueshem per te hequr tubat e demtuar. Tubat HDPE bashkohen, me shkrirje ose me elektrofuzion.

12.4. Kerkesa te perbashketa .

12.4.1. Tabani i kanalit nuk duhet te jete i shkriftezuar. Nese ky taban eshte i shkriftezuar, atehere duhet qe perpara vendosjes, ai te dystohet, shtypet ose te mbulohet me nje shtrese te posaçme. Edhe siperfaqet e shkriftezuar, por jo te forta duhet te ngjeshen.

Neqoftese kemi te bejme me siperfaqe shkembore ose gurore, duhet qe fundi i kanalit te ngrihet te pakten 0.15 m dhe siperfaqja te mbulohet me nje shtrese pa gure (shih Projektin). Kesaj mund t'i shtrohet rere, zhavorr i imet ose toke e paster dhe masa e krijuar ngjeshet.

12.4.2. Thellesia minimale e shtrimit zakonisht diktohet nga intersektimet me tubacionet komunale ekzistuese (te ujit, te rrjetit elektrik, telefonik, te ujrave te shiut etj). Ne rruget me trafik te rende nuk rekomandohet qe tubat te shtrohen me mbulim me te vogel se 1.0 m. Ne raste te tilla mund te propozohet nje veshje me beton. Thellesia e lejuar e hapjes se seksionit te kanalit jepet ne projekt.

12.4.3. Duhet bere kujdes qe fundi i kanalit ku do te shtrohen tubat te jete i rrafshet, pa gure dhe mjaft i forte. Ne qofte se ne germimin me eskavator kjo nuk sigurohet, atehere 20 cm-at e fundit duhen germuar me krahe.

12.4.4. Te gjitha linjat kryesore te ujit te instaluar nen kete kontrate do te jene subjekt i testimi hidrostatik, i cili do te kryhet me shpenzimet e Kontraktorit si pjese e punes per instalimin e rrjetit kryesor te ujit. Kontraktori duhet te furnizojë pompen, bashkimet e tubit, matesit e ujit, sahatet, dhe te gjitha aparaturat e kerkuara per testimin, punetore dhe supervizionin e kerkuar per pergatitjet dhe per kryerjen e testimi hidrostatik.

12.4.5. Kontraktori duhet te jape te gjitha fasilitetet e nevojshme dhe punetoret dhe duhet te komplotojë ne menyre te kenaqshme mbushjen e te gjitha linjave kryesore te ujit te instaluar nen kete kontrate, si pjese e instalimeve te linjes kryesore te ujit. Uji i kerkuar per mbushjen duhet te perftohet nga Kontraktori me shpenzimet e vete Kontraktorit.

12.4.6. Mbushja me uje e tubave te linjes se ujit duhet qe te kryhet pasi testi hidrostatik te kete perfunduar ne menyre te sukseshme dhe perpara se te kryhet disinfektimi i linjave kryesore te ujit.

Mbushja me uje e tubave te ujit duhet te kryhet seksion per seksion. Per cdo valvul te cdo seksioni te linjes se tubit te ujit Kontraktori duhet te beje nje lidhje provizore



ndermjet linjes se tubit te ujit ekzistues dhe linjes se tubit te ujit nen test. Uji duhet te pompohet nga sistemi ekzistues tek seksioni qe fillon te mbushet me uje. Te tjera parapergatitje per maganizimin dhe pompimin e ujit, do te jene subjekt i aprovimit nga Supervizori. Kujdes i vecante duhet marre nga Kontraktori per disponimin e ujit. Linja e tubit te ujit duhet qe te mbushet me uje, duke mbajtur te gjitha degezimet e tubave hapur. Mbushja me uje duhet te vazhdoje derisa uji i paster te filloje te rrjedhe nepermjet fundit tjetër.

12.4.7. Kontraktori duhet te furnizoje te gjithë makinerite, punetoret dhe materialet per disinfektim te rregullt te linjes kryesore te ujit te instaluar nen kete kontrate, si pjese e instalimit te linjes kryesore te ujit, me shpenzimet e vete Kontraktorit. Disinfektimi duhet qe te kryhet me klorinim, pasi linja e ujit te jete testuar per pikimin por perpara se ajo te jete lidhur me sistemin e ujesjellesit ekzistues. Disinfektimi i linjes se tubit te ujit duhet te kryhet ne prezencen e Supervizorit dhe me makinerite e aprovuara.

12.4.8. Duke ndjekur disinfektimin komplet te linjes se tubit, i gjithë uji i trajtuar duhet qe te derdhet nga tubi i linjes ne ekstremet e tij. Uji i trajtuar dhe uji i perdorur per mbushjen duhet qe te hiqet nga Kontraktori ne nje menyre te aprovuar nga Supervizori. Tubi i linjes se ujit duhet qe pastaj te mbushet me uje te fresket dhe uji te testohet per prezencen e klorinit, siç specifikohet me poshte. Tubi i linjes se ujit do te jete mbushur ne menyre adekuate keshtu qe te kemi nje maximum te klorit te mbetur e 2PPM

12.4.9. Per lidhjen e rrjetit te ri te ujesjellesit me rrjetin kryesor "ne gjendje pune" te ujesjellesit, Kontraktori duhet qe te jape te gjitha te vecantat ne perputhje me tipin e tubit qe do te lidhet. Te vecantat e kerkurara, per te bere qe puna te perfundoje do te prokurohen nga Kontraktori me koston e tij. Kontraktori duhet t'i jape Punedhënesit te pakten njoftim 3 dite pune perpara planit te tij per te bere lidhjen me Linjen kryesore te ujesjellesit. Punedhënesi do te jape njoftimin e nevojshem per kete veprim, duke nderprere kalimin e ujit ne linjen kryesore .

12.4.10. Kontraktori duhet te kryeje sa me shume pune qe te jete e mundur perpara se linja kryesore te jete nderprere dhe kur nderprerja e ujit ne linjen kryesore te jete bere efektive, ai do te procedoje me berjen e lidhjeve ne vazhdimesi dhe sa me shpejt qe te jete e mundur, ne menyre qe te minimizoje periudhen e nderprerjes se ujit. Perpara se linja kryesore ekzistuese e ujesjellesit te rilidhet dhe te vendoset ne sherbim, nje sasi e klorit te gelqeres, siç specifikohet nga Supervizori duhet te futet ne tuba nga Kontraktori

12.4.11. Gjate marrjes ne dorezim te rrjetit te jashtem te ujesjellesit:

- Kontrollohet pershtatja e punimeve te zbatuara me projektin dhe me keto specifikime teknike;
- Te gjithë tubat i nen shtrohen proves hidraulike per qendrese dhe hermeticitet;
- Kontrollohet gjendja e rregullt e armatures se instaluar.
- Tubat prej celiku, gize dhe plasmasi i nenshtrohen proves se ndermjetme hidraulike , me llogore te hapur, dhe proves definitive pas mbylljes se llogores.

12.4.12. Provat hidraulike behen duke zbatuar rregullat qe vijojne:



Provat behen me sektore me gjatesi jo me te madhe se 1km(keto kufizime nuk jane te detyrueshme per tuba prej celiku).

Provat behen pa hidrante, pa valvola sigurimi dhe ventuza. Saracineskat ne sektorin per t'u kontrolluar, duhet te jene te hapura fare. Te gjitha degezimet dhe kokat e lira duhet te jene te mbyllura. Nuk lejohet te perdoren per kete qellim saracineska te vendosura ne degezimet dhe kokat e lira ne vend te flanaxhave tape.

12.4.13.Tubat mbushen dhe gjate ketij veprimi duhet te sigurohet heqja e plote e ajrit nga vendet e posacme te daljes se ajrit, nga te gjitha pikat e ngritura te kondukturave ku ka mundesi te grumbullohet ajri.

Berja e provave hidraulike te tubave mund te fillohet ne afatet e treguara me poshte, qysh nga casti i mbushjes me uje te tubave per t'u provuar:

- | | | |
|-------|---------------------------------------|----------|
| (i) | tuba metalike me gote mbas 0.5-1 dite | 24 oresh |
| (ii) | tuba me gote mbas 1-2 dite | 24 oresh |
| (iii) | tuba plasmasi mbas 1-2 dite | 24 oresh |

12.4.14.Provat behen sipas rradhes qe vijon:

Ne tubat e mbushur me uje dhe me ajrin e hequr, me anen e preses ngrihet presioni deri ne presionin (H) per t'u provuar dhe presa izolohet.

Me anen e kronometrit llogaritet koha (T1) ne te cilen presioni do te bjere 1 atm.

Presioni ne tuba ngrihet perseri deri ne presionin (H) fillestar te proves dhe presa izolohet.

Me celjen e rubinetit nr.4 formohet humbja plotesuese dhe perseri llogaritet koha e uljes se presionit per 1 atm (T2). Gjate kesaj kohe matet sasia e ujit (W) qe rrjedh ne kete kohe nga rubineti nr.4.

Shkalla e hapjes se saracineskes nr.3 qe krijon rrjedhjen plotesuese, caktohet ne menyre qe sasia e ujit qe rrjedh nga tubacioni te jete jo me shume nga ajo e lejueshme per tubat qe jane ne prove.

12.4.15. Perfundimet e proves konsiderohen te kenaqeshme n.q.se tubat mbajne presionin e proves pa u prishur gjendja e rregullt e tubave, d.m.th. gjate kesaj kohe nuk duhet te shkaktohen plasje ne tubat ose ne pjeset speciale, ose te prishen vendet e bashkimeve dhe gjithashtu n.q.se humbja gjate proves llogaritur per 1 atm, per diametrat e ndryshem dhe per gjatesine 1 km nuk do te tejkaloje:

- Per tubat prej gize, 1m³ /24 ore ose 0.7 litra/min.
- Per tubat prej eterniti ose betoni te armuar, 2m³ /24ore ose 1.39 litra/min.
- Per tuba prej celiku, 0.4 m³/24 ore ose 0.28litra/min.
- Per tubat prej plasmasi

12.4.15.Pas proves hidraulike te tubave behet shplarja e tyre me uje te paster, me shpejtesi te madhe (deri 2m/sek). Shplarja duhet te behet me sektore me gjatesi deri ne 1 km, dhe kjo varet nga mundesia e zbrazjes se konduktures. Ne mungese te kesaj vend-zbrazje ne sektorin ne fjale, zbrazja e ujit behet me anen e hidranteve, ose pjeseve speciale te pershtatura per kete qellim. Shplarja behet deri ne pastrimin e plote, ne menyre qe ne uje te mos mbetet asnje perzierje ose turbulllore.



12.4.16.Rrjeti i ujesjellesit per sherbime dhe uje te pijshem, mbas shplarjes duhet t'i nenshtrohet klorifikimit, ne marreveshje me inspektorin sanitar. Per kete, tubat mbushen me uje, qe permban 20-30mg klor aktiv per nje liter uje.

12.4.17.Uji i klorinuar duhet te mbahet ne tuba jo me pak se 24 ore. Sasia reziduale e klorit brenda ne uje , mbas klorifikimit definitiv te ujesjellesit nuk duhet te jete me e vogel se 0.1mg per liter.

12.4.18. Dhenia dhe marrja ne dorezim e rrjetit te jashtem te ujesjellesit vertetohet me proces – verbal. Komisionit per marrjen ne dorezim te rrjetit te ujesjellesit i paraqiten keto dokumenta teknike:

Vizatimet e projektit te ujesjellesit qe do te dorezohet, me ndryshimet dhe plotesimet e bera gjate zbatimit te punimeve.

Proces-verbalet e punimeve te maskuara dhe per provat paraprake te rrjetit te ujesjellesit dhe te armatures.

12.5. Pershkrimi i cmimit njesi te tubave te ujesjellesit

Kosto e germimit, mbulimit dhe transportit te tubave jane perfshire ne pershkrimin e cmimeve njesi qe lidhen me keto punime.Furnizim i tubacioneve te gjitha diametrave, mbajtja, shtrirja, furnizimi i te gjitha materialeve te nevojshme, veglave, paisjeve te kerkuara per shtrimin e tubave, fuqia puntore, pershtatesit, bashkuesit, izoluesit, prova e tubave, sigurimi dhe instalimi i shiritave me ngjyre, sheshimi i siperfaqes, hekuri dhe armimi i tubave dhe te gjitha aktiviteteteve sic pershkruhen me siper jane perfshire ne cmimin njesi per nje meter tubacion ujesjellesi.

Matja: Linja e qendres se tubave do te matet ne meter linear nga faqja e brendeshme e pusetes ne faqen e brendeshme te pusetes pasuese pergjate aksit te tubit

12.6. Asnje tub i krisur, i thyer apo me difekt nuk do te perdoret ne veper. Demtimi i pjeses fundore te tubave qe sipas Supervizorit mund te shkaktoje lidhje difektoze, do te jete shkak i mjaftueshem per te hequr tubat e demtuar.

Tubat do te pastrohen plotesisht nga mbeturinat ne brendesi perpara se te instalohen dhe do te mbahen te paster ne pergjegjesine e Kontraktorit deri ne marrjen ne dorezim te punimeve. Te gjitha kontaktet siperfaqesore te bashkimeve do te mbahen te pastra deri sa te kete perfunduar bashkimi, Do te merren masa per ndalimin e futjes se materialeve te huaja ne brendesi te tubave gjate instalimit. Ne tuba nuk do te vendosen mbetje, vegla pune, rroba ose materiale te tjera.

12.7. Ndertimin e pusetave me permasa 1x1x1.5 dhe 1.5x1x1.5m

Ajo duhet te sigurve patjeter:

12.7.1.Largesia nga fundi i pusetes deri tek buza e poshtme e gotes ose e fllanxhes, jo me pak se 0.10m.

12.7.2.Largesia nga fllanxha deri tek muri, ne drejtim te aksit, duhet te jete jo me pak se 0.10m, kurse ne drejtim terthor me aksin jo me pak se 0,15m nga buza e jashtme e



flanaxhes per tuba me diameter deri ne 450mm dhe jo me pak se 0.30m deri tek muri per tubat me diameter me te madh se 450mm.

12.7.3. Largesia nga buza e jashtme e gotes deri tek muri (ne drejtim terthor me aksin) duhet te jete ne tubat me diameter deri ne 450mm jo me pak se 0.25m dhe per tubat me diameter me shume se 450mm jo me pak se 0.35mm.

12.7.4 Muret e betoni ose prej tulle te realizuar me llac cimentoje. Trashesia e mureve te pusetave te rrumbullaket,vezake apo drejtkendeshe nuk duhet te jete me i vogel se 25 cm.

12.7.5. Dyshemeja e pusetave duhet te behet prej betoni , me trashesi 10 cm.

12.7.6. Ne toka qe mbajne uje, siperfaqja e jashtme e pusetave suvatohet me lluster cimento deri ne lartesine 20-30cm mbi nivelin e ujerave te nentokes, ndersa ne kushte me te veshtira pusetat vishen me hidroizolim.

12.7.7. Pusetat e rrumbullaketa prej betoni mund te behen prej rrathesh ne forme unaze te gatshme prej betoni, ose qe derdhen ne vend. Gjate berjes se pusetave prej unazash betoni bashkimet duhet te jene pastruar nga papastertite dhe pluhuri dhe te shplahen me uje. Unazat vihen me llac cimentoje. Vend takimet e unazave duhet te jene te pastra dhe te lemuara.

12.7.8. Ne muret e pusetave vihen ne menyre te alternuar ganxha prej celiku te rrumbullaket ose pllocak, me largesi ndermjet tyre ne drejtim vertikal 30-40cm dhe ne drejtim horizontal ndermjet akseve te ganxhave 30-35cm.

12.7.9. Solete beton/arme, e armuar ne menyre te rregullt, furnizuar dhe vendosur ne veper, duke perfshire nje hapje rrethore 60 cm e cila mbyllet me nje kapak gize me diameter 60 cm, e suvatuar me llac cimento m-1:2 me trashesi 2 cm, me dozim si me siper, dhe me shtesa materiali kunder tkurrjes se betonit dhe pengues uji (Uoter stop);

12.7.10. Grykat e pusetave, kur rruga eshte me kalldrem, behen me te larta nga siperfaqja e rruges, por jo me teper se 2cm; ne vendet e pashtuara ngrihen 5cm, duke bere rreth tyre nje pjese te pjerret deri ne siperfaqen e tokes, me gjeresi 1m. Ne rruget me shtrese te mire kapaket prej gize ,vihen rrafsh me siperfaqen e rruges.

12.7.11. Ne cdo rast, ndermjet mureve te pusetes dhe tubave duhet te lihet nje boshllek prej 3cm per tu mbushur me li dhe argjil.

12.7.12. Perfshire cdo detyrim tjeter dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte. Dhe garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

13. Kanalizimet e jashtme



13.1. Per punimet e germimit dhe te mbushjes se kanaleve do te shfrytezohen te dhenat per germimet.

13.2. Tuba plastik P.V.C. per sistemin e kanalizimeve, me numer te pershtatshem lidheshesh, do te instalohen sipas udhezimeve ne vizatime. Tubat do te kene permasa sipas 200,250 dhe 315 cm. Bashkimet do te behen me manikota dhe rakorderi sipas kerkeses qe ngjiten me ngjites te pershtatshem per tubat P.V.C. Nuk pranohen bashkime te pangjitura.

13.3. Te gjitha punimet e shtrimit te tubacioneve, skelat e sherbimit, cdo gje sipas udhezimeve ne projekt si dhe cdo detyrim tjeter dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

13.4. Puseta kontrolli sipas udhezimeve ne vizatime, dhe realizuar si me poshte:

13.4.1. Germim me seksion te caktuar ne terren te cfaredolloj natyre dhe konsistence duke perfshire spostimin e mbeturinave brenda ambientit te kantierit;

13.4.2. Shtrese zhavorr lumi ;

13.4.3. Shtrese beton m-100 ,

13.4.4. Murature me tulla te plota me dozim sipas permasave te pusetes ose betony ;

13.4.5. Suvatim te pusetes me llac cemento ;

13.4.6. Kapak gize, me permasat e duhura per kalim makine ose kamioni, nese ka;

13.4.7. Mbushje duke perdorur materialin ne Kantjer qe ka rezultuar nga germimi,

13.4.8. duke perfshire cdo detyrim tjeter dhe mjeshteri per mbarimin dhe funksionimin e mire te pusetes.

Grupi projektimit : "Arkimade" & "Taulant" & "Vler-Invest" sh.p.k

Perfaqesuese: *Ditika QATIPI*